



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA

P.nr.73/2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC/Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ilir Rashkaj, me pjesëmarrjen e procesmbajtësit Shani Canziba, sekretar juridik i kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarve: N. K. nga fshati Ll., komuna e Malishevës dhe B. R. nga Malisheva, për shkak të veprës penale të vjedhjes në bashkëkryerje nga neni 325 paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.1202/2014 të datës 22.02.2016, në shqyrtimin fillestar publik, të mbajtur me datë 30.09.2019, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Enis Gashi, dhe të akuzuarve, të njëjtën ditë, mori dhe publikisht shpalli, këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

N. K., nga i ati M. dhe e ëma F., e lindur K., i lindur me datë ..., në fshatin Ll., komuna e Malishevës, ku dhe tani jeton, me nr. personal ..., ka të kryer tri klasë të shkollës fillore, i martuar, i ati i dy (2) fëmijëve, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i padënuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër për ndonjë vepër penale, dhe

B. R., nga i ati Sh. dhe e ëma Z., e lindur H., i lindur me datë ..., në fshatin P., komuna e Suharekës, tani me banim në Malishevë, rruga “R. K.”, p.nr., me nr. personal ..., ka të kryer shkollën fillore, i martuar, i ati i katër (4) fëmijëve, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i padënuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër për ndonjë vepër penale,

JANË FAJTORË

Sepse, me dt. 30.05.2014, afër rrugës Xërxë-Rahovec, rreth orës 00:20 min., me qëllim që vetit apo tjetrit ti sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, me qëllim vjedhje, të akuzuarit merren vesh mes veti, shkojnë me automjet me regjistrim të skaduar, me targa të regjistrimit ...-....-..., pronë e G. A. nga fshati B., komuna e Podujevës dhe e ndalin automjetin buzë rruge e hyjnë në hapësirën e parkingut të firmës “H.”, nga fshati Xërxë, komuna e Rahovecit, pronë e të dëmtuarit V. Gj. K. nga fshati R., komuna e Gjakovës, e nga dy kamionet e firmës i vjedhin katër (4) copa baterij, e me të shpejtë me automjet largohen nga aty, e duke u larguar në udhëkryq, në hyrje të Rahovecit, rruga “Xh. H.”, afër parkingut të firmës “B.”, ndalen nga policia, e pas një kontrolli policore bateritë vjedhura janë gjetur në automjet dhe u sekuestrohen e i kthehen të dëmtuarit.

-Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale të vjedhjes nga neni 325 paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 46 par.1 pika 1.1, 47, 48, 49, 69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale, i shqipton:

DËNIMIN ME KUSHT

Ashtu që:

Të akuzuarin **N. K.**, e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëqind e njëzet (120) ditëve, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do të ekzekuton në afatin kohor prej një (1) viti, që nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk e kryen vepër tjetër penale, dhe

Të akuzuarin **B. R.**, e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëqind e njëzet (120) ditëve, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do të ekzekuton në afatin kohor prej një (1) viti, që nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk e kryen vepër tjetër penale.

Obligohen të akuzuarit, që në emër të shpenzimeve të procedurës penale - paushallit gjyqësor, secili të paguaj shumën prej tridhjetë (30) Euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

I dëmtuari V. Gj. K. nga fshati R., komuna e Gjakovës, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko - civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzën, PP.nr.1202/2014 të datës 22.02.2016, me të cilën i ka akuzuar të pandehurit N. K. nga fshati Ll., komuna e Malishevës dhe B. R. nga Malisheva, për shkak të veprës penale të vjedhjes në bashkëkryerje nga neni 325 paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe ka propozuar që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimit të provave i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata, me datë 30.09.2019, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, me ç'rast kanë marrë pjesë: Prokurori i Shtetit Enis Gashi dhe të akuzuarit N. K. e B. R..

Prokurori i shtetit edhe pas leximit dhe analizimit të aktakuzës ka qëndruar në tërësi pranë saj.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar aktakuzën, të njëjtëve i'u ka dhënë mundësinë që ta pranojnë ose të mos e pranojnë fajësinë, por paraprkisht u'a ka tërhequr vërejtjen lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale që u ngarkohet.

I akuzuari N. K., ka deklaruar se: E pranon fajësinë për veprën penale, është penduar shumë për veprën që e ka kryer, kjo ka qenë hera e parë dhe e fundit që ka ra në kundërshtim me ligjin dhe nuk do ta përsërisë kurrë, si dhe ka deklaruar se sendet të cilat i kanë marrë, i janë kthyer të

dëmtuarit. Po ashtu ka shtuar se këtë e ka bërë pasi në atë kohë ka qenë i gjendjes shumë të dobët ekonomike dhe nuk i ka ditur pasojat. Ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej veprë tjetër penale, si dhe ka lutur gjykatën që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, të ketë parasysh rrethanat e lartcekura, e sidomos faktin se është i gjendjes së varfër ekonomike, mbajtës i familjes dhe të ardhurat e vetme i siguron nga puna në bujqësi, e të cilat nuk i mjaftojnë as për gjërat elementare, dhe t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë.

I akuzuari B. R., ka deklaruar se: është penduar shumë për veprën që e ka kryer, por ka shtuar se këtë e ka bërë për shkak të kushteve të vështira ekonomike. Gjithashtu ka shtuar se kjo është hera e parë dhe e vetme që ka rënë në kundërshtim me ligjin, si dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej veprë tjetër penale. E ka lutur gjykatën që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, të ketë parasysh të gjitha rrethanat e cekura më lart, e sidomos faktin se është i gjendjes së varfër ekonomike, mbajtës i familjes dhe të ardhurat e vetme i siguron nga puna në bujqësi, e të cilat nuk i mjaftojnë as për gjërat elementare, dhe t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë.

Gjykata, gjithashtu e ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit sa i përket pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarve.

Prokurori i Shtetit Enis Gashi, ka theksuar se: Nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, pasi që të njëjtit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e fajësisë e kanë bërë me vetëdije dhe vullnet të plotë, si dhe pranimi i fajësisë mbështetet në prova dhe faktet cilat gjenden në shkresa të lëndës. Po ashtu i ka propozuar gjykatës që me rastin e caktimit dhe matjes së dënimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese, si dhe ato rënduese nëse gjenë dhe të njëjtit ti shpall fajtorë, dënoj në bazë të ligjit, si dhe ti obligojë në kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale.

Duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë më lartë, e meqenëse janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 par.1 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe nuk është lëshuar në procedurën e provave e as në fjalën përfundimtare por e ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktakuzës.

Gjykata ka gjetur se të akuzuarit kanë kryer veprën penale të vjedhjes në bashkëkryerje nga neni 325 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte e përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë:

- deklaratat e të akuzuarve, të dhëna në SP. Rahovec, me dt.30.05.2014;
- deklarata e të dëmtuarit, e dhënë në SP. Rahovec, me dt.30.05.2014;
- raporti i shkurt i dt.30.05.2014;
- raporti i oficerit i dt.30.05.2014;
- dëftesa mbi sekuestrimin e sendeve e dt.30.05.2014;
- vërtetimin mbi sekuestrimin e sendeve, e dt.30.05.2014, si dhe
- foto dokumentacioni dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë, janë prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se të akuzuarit kanë kryer veprën penale e cila u vihet në barrë.

Prandaj në bazë të këtyre provave dhe vet pranimin të fajësisë, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit ti shpall fajtorë dhe ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese të parapara në nenet 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së

Kosovës, të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata, rrethana veçanërisht rënduese nuk ka gjetur, ndërsa si rrethana lehtësuese për të dy të akuzuarit ka vlerësuar rrethanat personale të tyre, pasi që të njëjtit janë të martuar dhe mbajtës të familjeve, është hera e parë që kanë rënë ndesh me ligjin, janë penduar dhe kanë kërkuar falje për veprën penale të cilën e kanë kryer, por këtë e kanë bërë pasi që në atë kohë kanë qenë të gjendjes shumë të varfër ekonomike, të moshës së re dhe nuk i kanë menduar pasojat. Premtimin se në të ardhmen do të jenë më të kujdesshëm dhe nuk do të kryejnë vepra të tjera penale të kësaj natyre apo çfarëdo vepre tjetër penale, ndërsa për të akuzuarin e dytë, si rrethanë lehtësuese mori parasysh edhe faktin se i njëjti jeton nga puna e kohëpaskohshme fizike dhe me të ardhurat që siguron mezi arrin të siguroj ekzistencën e familjes.

Andaj, gjykata ka ardhur në përfundim se me shqiptimin e dënimit me kusht, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së dhe ky dënim është në propocion me peshën e veprës, me sjelljen dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit, si dhe konsiston në parandalimin e kryerësve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, rehabilitimin e tyre, si dhe të përmbajë personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u mor konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar. 2.6, lidhur me nenin 453 paragrafi 1 të KPPK-së.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontest civil sipas nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC

- Divizioni Penal -

P.nr.73/2016 datë 30.09.2019

Sekr. juridik,
Shani Canziba

Gjyqtari i vetëm gjykses,
Irir Rashkaj

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.